



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 7088 /2024
Data: 20.08.2024

PROCESVERBAL I KOMITETIT PER KOMUNITET

Nga mbledhja e shtatë -VII-për vitin 2024 i Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 29.07.2024 me fillim pune në ora 14:00në sallën e takimeve. Prezent ishte zyrtari i Zyrës së Prokurimit z.Avdush Bajramaliu.

RENDI I PUNËS

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
- 2.Takim me Zyrtarin e Zyrës së Prokurimit.
- 3.Takim me Drejtorinë e Urbanizmit, Kadastër dhe Mbrojte të Mjedisit
- 4.Eventuale

U MIRATUA RENDI I PUNËS

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Takim me Zyrтарin e Zyrës së Prokurimit.

Kryesuesi thekson: Sa janë harxhuar buxhet komunal në gjashtë mujorin e parë.

Avdush Bajramaliu thekson: Realisht drejtoria e financave ka për detyrë buxhetin ndërsa ne e kemi nënshkrimin e kontratave dhe si zhvillohet procedura.

Kryesuesi thekson : Sa kontrata janë nënshkruar , sa janë nën njëmijë euro dhe mbi njëmijë euro.

Avdush Bajramaliu thekson: katërdhjet e dy kontrata në fund të qershorit ka kontrata mbi dhe nën njëmijë euro . Siç janë furnizim dhe montim me perde , furnizim me material stomatologjik, mirëmbajtja e ndriçimit publik, shërbime konsulente psikologe , furnizim me material të laboratorit , furnizim me material për zyrë jashtë listës së AQPS , gjithsej katërdhjet e dy kontrata nuk e kam si statistike sa janë nën njëmijë euro dhe sa janë mbi njëmijë euro .

Kryesuesi thekson: A ka ndodh qe një kontratë të përsëritet dy herë.

Avdush Bajramaliu thekson: Ka raste kur ka dështuar kur nuk ka ofertues

Kryesuesi thekson: Më herët ka ndodh që kontrata është përsërit dy herë është fut në shpenzime.

Avdush Bajramaliu thekson: nuk ndodh përveç se një procedurë nuk ka oferta përsëritet dy herë.

Resul Suma thekson: Përmbaruesi a i merr fondet nga ju apo nga drejtoritë dhe a mundet ti merr nga kontrata

Avdush Bajramaliu thekson: Realisht i merr nga drejtoritë , po nëse janë të lira nuk janë të shpenzuara i merr nga kontrata.

Zaim Bela thekson: A keni shpall tender për furnizim me drunj.

Avdush Bajramaliu thekson : Po e kemi shpall furnizimin me drunj diku ka qenë tetë oferta me e lira ka qene 34 euro njësi.

3. Takim me Drejtorinë e Urbanizmit, Kadastër dhe Mbrojte të Mjedisit

Kryesuesi thekson: njoftimi i është bërë me kohë por pasi që nuk është prezent askush nga kjo drejtori kalojm në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

4. Eventuale

Anëtarët e Komitetit për Komunitete diskutuan rreth çështjes se ujit , ndriçimit publik, ditët e mërgatës dhe dukurive negative në Komunën e Hanit të Elezit përdorimi i narkotikëve si dhe parandalimi i tyre po ashtu ata rekomanduan programe rreth parandalimit të dukurive negative.

Mbledhja përfundoi në 14:40

Procesmbajtësja
Sara Berisha

